



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 19 prill 2016, në mbledhjen e dytë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.05

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Bekim Jashari, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Sami Ajeti, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Nivel komunal; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z. Faik Muçiqi, përfaqësues i Emergjencave Civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim; z. Bunjamin Hoti, përfaqësues i OJQ-ve; z. Fadil Halimi, përfaqësues i Mediave lokale; z. Avni Shabani, përfaqësues i Komunitetit të biznesit dhe z. Idriz Hoxha, përfaqësues i komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa mungoi: z. Sabedin Rama, përfaqësues i Komunitetit rom.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: z. Avni Fetahu, Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Përfaqësuesitë e OSBE-së- znj. Laia Pau Romani, Skender Shatri dhe Muharrem Haziri.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, Mirë se keni ardhur, më lejoni të hapi mbledhjen e II(dytë) të KKSB-së, për këtë vit. Rëndin e ditës me materialet përcjellëse besoj se i keni marrë me kohë. Nëse jeni dakord mund të fillojmë me punë.

1. Rend i propozuar i ditës

U miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 16 shkurt 2016

U miratua njëzëri

3. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë -Tendencë e rritjes së veprave penale të vjedhjeve

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Bekim Bislimi.
z. Bekim Bislimi, ju informoj se gjendja e sigurisë në komunë është relativisht e qetë. Jemi duke punuar në zbatim të ligjit dhe ruajtjes së rendit duke patur një bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante në komunë, në funksion të krijimit të një ambienti sa më të qetë dhe sa më të sigurt për qytetarët. Në kuadër të aktiviteteve tona kemi mbajtur takime me KLSB- të, me qëllim të identifikimit të problemeve të mundshme, kemi adresuar gjendjen e rrezikut që paraqet djegia e amullive në këtë

periudhë, kemi adresuar edhe ngritjen e bashkëpunimit. Gjatë kësaj periudhe kemi ofruar asistencë dhe kemi bashkëpunuar me institucionet komunale sa i përket ngritjes së sigurisë në komunikacion, kemi asistuar Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në parandalimin e dukurive të zjarreve. Bazuar në rastet e raportuara dhe informacioneve nga terreni kemi përmirësim të situatës. Gjithashtu kemi punuar në parandalimin e vjedhjeve. Sipas vlerësimeve tona gjendja raportuese në komunikacion është e njëjtë me atë të vitit paraparak. Përkundër angazhimeve tona ka tendencë të ngritjes së veprave penale të vjedhjeve dhe vjedhjeve të rënda. Kjo gjendje është krijuar si pasojë e angazhimeve të shumta që kemi pasur në Prishtinë që ka rezultuar me një mungesë të ndjeshme të burimeve njerëzore. Kur jemi te bashkëpunimi me qytetarët e vlerësoj shumë pozitiv rastin e datës 09.04.2016 ku falë ndihmës nga ana e qytetarëve dhe bashkëpunimit me Policinë i shpëtuan jetën një fëmijë tre vjeçar i cili aksidentalisht kishte ra në lumin Llap. Në bazë të të dhënave gjendja e sigurisë në periudhën raportuese pritet të jetë e qetë dhe stabile. Nuk ka informacion relevant se në periudhën vijuese do të ketë element kriminal që do të ndikonte në çrregullimin e rendit dhe sigurisë publike. Me qëllim të krijimit të sigurisë së qëndrueshme dhe stabilitet afat gjatë kemi përgatitur plane konkrete operative dhe po punojmë në implementimin e tyre me qëllim të parandalimit të veprave të ndryshme penale. Nuk kam diçka tjetër për të shtuar nëse keni ndonjë pyetje jam i gatshëm të përgjigjem.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, pasi që përfaqësuesit e KFOR-it nuk janë prezentë e hapi diskutimin lidhur me raportin e paraqitur nga Komandanti i Stacionit të Policisë.

Unë sigurisht se jam i kënaqur me gjendjen e cila po vlerësohet edhe prej kompetentëve si situatë e qetë edhe një gjendje që nuk pritet të ketë çrregullime, dmth është një vlerësim i mirë, mirëpo shtimi i veprave penale të vjedhjeve, krahasuar me një periudhë të kaluar, është diçka që ne duhet ta diskutojmë. Gjatë raportimit vëreja një lloj arsytimi që e paraqiti komandanti që sipas këtij vlerësimi kjo është si pasojë e mungesës së personelit. Stacioni Policor në Podujevë në bazë të vlerësimeve nuk ka personel të mjaftueshëm, përveç kësaj stafi ka qenë dhe angazhohet edhe në punë dhe detyra tjera jashtë territorit të komunës. Nëse ka të dhëna Komandanti kisha kërkuar që të prezantoj numrin e zyrtarëve policor dhe si është gjendja, me çfarë mungesash përballet. Duke marrë përbazë këtë, ne nga ky takim të dalim me një konstatim se për komunën e Podujevës, me hapësirën dhe numrin e banorëve që ka, se a është ky numër i mjaftueshëm krahasuar me komunat tjera apo jo dhe se a është e nevojshme që të paraqesim kërkesë te Drejtori i Policisë së Kosovës që të kenë parasysh për rritjen e stafit nëse ekzistojnë mundësitë. Paraprakisht të ndëgjojmë Komandantin dhe pastaj të vijmë në një përfundim lidhur me këtë.

z. Bekim Bislimi, Stacioni Policor i Podujevës, përfshirë edhe nënstationin e Policisë në Orllan duhet të ketë 91 zyrtarë policor. Prej tyre aktualisht jemi 77 dmth 14 janë mungesë. Nëse i referohemi edhe periudhës tremujore ku në mënyrë permanente kemi qenë 30 zyrtarë policorë të angazhuar, atëherë rezulton të jemi 65 zyrtarë, prej tyre 12 janë në Nënstationin e Policisë në Orllan, në Stacionin e Policisë në Podujevë mbesin 55 zyrtarë. Nëse i referohemi edhe çështjeve të tjera siç kemi mungesë të tyre për shkak të gjendjeve të tyre shëndetësore dhe trajtimet e tyre, përfshirë pushimet mjeksore, rezulton se kemi qenë ndjeshëm në mungesë të burimeve njerëzore. Është shenjë pozitive se grupi i zyrtarëve policorë prej 12 i cili ka qenë permanent i angazhuar në qendër është kthyer megjithatë ende jemi në mungesë për 14 zyrtarë. Duke marrë parasysh territorin e komunës diku prej 633 km² dhe numrin e banorëve, një brez kufitarë ku është prezent kontrabandimi, ky numër i zyrtarëve është shumë i vogël dhe nuk është në gjendje për tu përballuar me të gjitha sfidat që kemi. Kjo është gjendja reale e personelit.

z. Faik Muçiqi, shtroi pyetje se a pritet të shtohet numri i zyrtarëve policor pasi që ka dalë një gjeneratë e re e zyrtarëve policorë.

z. Bekim Bislimi, gjenerata e re që ka përfunduar kualifikimin është sistemuar në Prishtinë. Te ne realisht nuk ka arritur asnjë pjesëtarë i gjeneratës së re të policisë.

z. Liman Zeqiri, nëse i referohemi ne si komunë që jemi një prej komunave më të mëdha në Kosovë në kuptimin gjeografik dhe atë të banorëve dhe në rrethanave të tjera që i paraqiti komandanti, kontrabandimin dhe elemente tjera, atëherë konsideroj se është çështje problematike që të menaxhohet ky territor me këtë numër të vogël të policëve, që të ketë një situatë më stabile, andaj kisha shtruar pyetje se a ekzistojnë mundësitë për shtimin e numrit të zyrtarëve policor.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, nëse nuk ka dikush tjetër diçka për të të shtuar atëherë ne mund ta përmbyllim këtë pikë, nëse jeni dakord, sipas raportimit të komandantit situata vlerësohet e qetë, pa

ndonjë problem të theksuar. Nëse jeni dakord dalim me një përfundim se na shqetëson fakti i rritjes së numrit të vjedhjeve dhe sipas raportit, arsye në rend të parë është mungesa e stafit policor. Nga informata për numrin aktual të zyrtarëve policorë, në bazë të vlerësimeve tona, konstatojmë se numri i stafit për komunën tonë është i pamjaftueshëm, dmth. edhe ai numër që është i lejuar nuk është i plotësuar, por kur i kemi parasyshë edhe këto elementet tjera që i tha komandanti, angazhimin e një numri të caktuar në detyra tjera vërehet një mungesë e stafit dhe duke marrë parasyshë të gjitha këto është kërkesë e këtij Këshilli për Drejtorin e Policisë dhe për Ministrin e MPB, të jetë si njoftim që ta ketë parasyshë komunën e Podujevës për shtimin e numrit të zyrtarëve policor.

5. Informatë për gjendjen e tanishme të zjarreve në territorin e komunës, me theks të veçantë në pyje, fushore etj. dhe masat parandaluese

-Informatë nga Shërbimi i Zjarrfikësve

-Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fjalën e ka z. Faik Muçiqi.

z. Faik Muçiqi. Në mungesë të Shefit të Shërbimit të Zjarrfikësve i cili ka qenë i ftuar lidhur me këtë pikë, por që mungon për shkak të angazhimeve, po prezantoj një informatë të shkurtër të intervenimeve të gjertanishme. Shërbimi i zjarrfikësve deri më tani ka 16 zjarrfikës, zyrtarët për parandalim dhe shefin, një punëtor i cili është i punësuar me kontratë mbi vepër dhe kemi një kërkesë për 4 punëtorë sezonal për të forcuar shërbimin për shkak të numrit të madh të punëve. Nga fillimi i vitit deri në me dt. 11.04.2016 kur është përgatitur informata Shërbimi ka intervenuar në 118 raste që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ku ka pasur 61 raste, që është një ngritje e madhe e intervenimeve, 100%. Nëse shikohet struktura e zjarreve. Nëse shikohet struktura e zjarreve për këtë sezonë pranverore kemi 51 raste të djegieve të pyjeve, pishave dhe fushave, për çka është shqetësuese. Para një kohe Kryetari i Komunës ka kërkuar nga institucionet relevante; AKP-së, Policisë, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së Inspeksionit për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për parandalimin e kësaj dukurie, megjithatë kjo gjendje është duke vazhduar. Sipërfaqet e dëmtuara nga djegiet kapin shifrat prej dhjetëra hektarëve, ku Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të jap shifra më të përafërta. Duhet theksuar se shkaktarë janë njerëzit në të gjitha rastet e djegieve, d.m.th. djegiet nuk janë shkaktuar nga temperatura e larta por temperaturat kanë ndikuar në përshkallëzimin e përhapjes së shpejtë të zjarreve, prandaj mbetet që policia të ketë hetime në rastet e tilla që konsiderohen të qëllimshme. Pra me që rastet janë të qëllimshme, është arsye që të veprojnë organet kompetente. AKP tani për tani nuk është në gjendje të ofrojë ndihmë, me punëtorë shtesë, përveç Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me rojet e pyllit. Zjarrfikësit dhe rojet e pyllit janë duke bërë përpjekje për parandalimin e zjarreve. Intervenimi në pyje është specifik, nuk ka mundësi për të hyrë me autocisterna, pra intervenimet bëhen me mjete të dorës gjë që është problem. Rojet e pyllit në rastet e zjarreve të pyllit duhet të informojnë policinë në mënyrë që policia të zhvillojë hetimet për shkakun e ndezjes. Shërbimi i zjarrfikësve është i kompletuar me pajisje, por duhet kërkuar nga AKP që sa më parë të ketë një korpus të ndihmës sikurse që ka vepruar në vitet e kaluara që ka ndihmuar sepse djegiet janë duke vazhduar ende, posaçërisht kur do të hyjmë në fazën e hamulloreve, që na përsëriten në masë më të madhe, fushave etje. Shërbimi është në detyrë 24 orë, marrim informacione nga Policia dhe nga qytetarët. Shqetësuese mbetet rastet e shumta të zjarreve kryesisht në pyje – pisha. Shkurtimisht, kjo është e tëra, nëse ka ndonjë pyetje jam në dispozicion të përgjigjem.

z. Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, theksoi, si Drejtori në kuadër të angazhimit për parandalimin e zjarreve kemi hartuar një plan operativ në koordinim me Policinë e Kosovës që besoj se ka shkuar mirë, ka pas për qëllim parandalimin e zjarreve por edhe të prerjeve ilegale të pyjeve. Shtoi, ka raste të shkakimit të zjarreve kur qytetarët po i pastrojnë arat dhe i djegin mbeturinat, por ka raste edhe të zjarreve të qëllimshme dhe kjo i takon Policisë që të veprojnë në kuadër të autorizimeve që kanë.

Përveç këtij hapi ne kemi përpiluar edhe një fletushkë që i referohet kësaj fushe, mbrojtjes së ambientit dhe vetëdijësimit të qytetarëve. Fletushka do të shpërndahet nëpër vendbanime, por është e nevojshme edhe në shkollat me qëllim të vetëdijësimit për dëmin që shkaktohet nga zjarri. Në kuadër të aktiviteteve të tjera kemi bërë mobilizim të rojeve të pyllit dhe koncentrimi është shumë më i

theksuar në këtë aspekt. Është fakt se ka numër më të madh të zjarreve, por është e vërtetë se asnjëherë mobilizimi nuk ka qenë më i mirë.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, e hapi diskutimin, nëse dikush ka diçka.

z. Bekim Jashari, kam një pyetje për z. Faik Muçiqin, Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, pasi që theksoi se Shërbimi i Zjarrfikësve nuk mund të intervenojë në të gjitha vendet, besoj në bashkëpunimin me KFOR-in, a mund të ofrojnë ata ndonjë ndihmë në këtë aspekt. Ndërkohë përshëndes edhe mendimin e Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për shpërndarje të fletushkave, sidomos me shpërndarjen e tyre nëpër shkolla.

z. Sami Ajeti, sa i përket veprimeve për parandalimin dhe intervenimet ndaj zjarreve, mendoj se Drejtoritë e Komunës duhet koordinuar punët me KFOR-in, për të na ndihmuar, pra që të jenë pjesëmarrës në këto aktivitete, ngase mund të ndihmojnë shumë në këtë drejtim.

z. Naim Bajraktari, sa i përket kapaciteteve tona, si jemi me njësi përkatëse të përgatitura në këtë lami, mirëpo deri më sot nuk jam në dijeni që kemi pas ndonjë intervenim. Kam pas biseda me zyrtarët e pylltarisë dhe jam i njoftuar me problemin, ka përfshirje të madhe të sipërfaqes pyjore nga zjarri, mirëpo duhet pasur koordinim nga ana e institucioneve të komunës me FSK-në, ku besoj se do t'i përgjigjemi rasteve.

z. Faik Muçiqi, mos të kemi dilema në këtë rast, dua të theksoj se është një procedurë e angazhimeve të FSK-së në rastet emergjente, të vërshimet, termetet, zjarret etj. Ne kemi pasur një rast para disa viteve por procedura duhet respektuar, së pari nëse shërbimi i zjarrfikësve komunal nuk është në gjendje të përballojë një fatkeqësi i drejtohet Shërbimit Regjional dhe kërkon ndihmë, nëse as nga ky shërbim nuk mund të ofrohet ndihmë atëherë ne i bëjmë kërkesë Agjencionit të Menaxhimit Emergjent, nëse edhe Agjencioni nuk ka kapacitet atëherë Agjencioni kërkesën ia dërgon FSK-së. Deri më tani nuk kemi pasur një rast të tillë. Te KFOR-i nuk kemi pasur kërkesa. Për heqjen e plepave në Qytet kemi pas kërkesa edhe pasi të gjitha procedurat janë zhvilluar nuk kemi marrë ndonjë përgjigje, për zjarre një kohë kemi intervenuar bashkërisht, pasi që ishte një zjarr i përmasave të mëdha, ndërsa tani nuk kemi zjarre të përmasave të mëdha.

z. Bekim Bislimi, sa i përket parandalimit të ndezjes së zjarreve, në takimin e kaluar e kemi potencuar dhe po e potencoj prap, para personave të papërgjegjshëm definitivisht nuk është e mjaftueshme parandalimi, ndalja e zjarreve, domosdo është në shprehje edhe sanksionimi i tyre, identifikimi i tyre, ngritja e kallëzimeve penale dhe zhvillimi i procedurave gjyqësore. Fatkeqësisht ne nuk po jemi të njoftuar me çdo rast kur ka ndezje të zjarreve dhe intervenim të Shërbimit të zjarrfikësve. Është e mirë dhe obligative që të njoftohet Policia në çdo rast ngase në mungesë të koordinimit nuk mund të identifikohen kryesit e këtyre veprave dhe nuk do të ketë rezultate. Nga takimi i kaluar deri më datën 5 nuk kemi pas asnjë informatë se ka pas ndezje të zjarreve.

z. Avni Shabani, sipas diskutimeve të zhvilluara, mendoj se ndoshta ka ngecje të bashkëpunimit apo mungesë të informacionit në rastet e zjarrvënësive me ç'rast Policia nuk informohet ose jo mjaftueshëm. Do të ndërlihdhesha me kohën e zjarreve të paraqitura. Jemi në periudhëm e hershme pranverore dhe shtrohet pyetja se çka do të ndodhë kur të hyjmë në sezonin veror, që bazuar në këto raporte dhe shifra besoj se rastet e zjarreve do të arrijnë shifrat diku 300- 400%. Kërkesa është që të jemi sa më vigjilent dhe më bashkëpunues dhe të jemi sa më afër të parandalimit dhe ndoshta nuk do të ishte metodë e keqe, ndoshta do të jepte rezultate më të mira të formohen disa komisione apo grupe punuese ose informuese, duhet mbajtur takime më tepër me banorët e atyre zonave që më së shumti janë të rrezikuara, për t'i këshilluar, që ata të shohin se cilat janë dëmet, sepse ata janë të parët që pësojnë nga dëmet. Pra kërkohet një bashkëpunim sa më unik në mënyrë që të shihen rezultatet.

z. Liman Zeqiri, unë pajtoj me të gjithë parafolësit. Ne me këtë temë jemi duke u marrë me vite dhe kjo ndërlihdet me vetëdijen qytetare. Pajtoj me drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ku theksoi se ka raste të qëllimshme. Atëherë nëse ka zjarre të qëllimshme duhet identifikuar personin dhe duhet sanksionuar, ngase vetëm ligji krijon rend dhe rregull dhe dënimet e merituar. Kjo mënyrë mendoj se ka ndikimin e vet dhe do të ndikonte dukshëm në zvogëlimin e kësaj dukurie. Në vjeshtë të vitit të kaluar tërë natën kam qëndruar në pyll me bashkëfshatarë, ngase u alarmua edhe burgu i sigurisë së lartë në Gërdoc ku u ndezën 10 ha, dhe kjo konsideroj se është bërë qëllimisht, mirëpo nuk do të thotë se nuk ka zjarre të rastësishme. Të bëhen gjithë këto zjarre e asnjë dënim apo sanksionim dhe asnjë individ të mos zbulohet atëherë kjo nuk është në rregull. Në këtë kontekst mendoj se duhet të bashkëpunojmë me përfaqësues të fshatrave ngase shumica janë në dijeni për personat e mundshëm që po dëmtojnë pyjet, sepse është e pamundshme, Policia dhe

pylltarët ta mbulojnë tërë këtë terren. Mendoj me një bashkëpunim të sinqertë të identifikohen personat dhe të sanksionohen.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, paraprakisht e kemi pasur një takim me komandantin e Stacionit të Policisë, Agjencionin e Pyjeve dhe Drejtorët e Drejtorive dhe kemi diskutuar këtë çështje, jemi dakorduar për angazhime dhe ngritjen e shkallës së mobilitetit. Deri më tani nuk kemi një përfundim të saktë lidhur me rastet e zjarreve të pyjeve, por supozimet janë që ndezjet janë të qëllimshme dhe për këtë arsye duhet të angazhohemi të gjithë faktorët, po ashtu ndihma e qytetarëve duhet të tregohet, duhet kërkuar prej tyre të na ndihmojnë edhe në paraqitje të rasteve edhe në zbulim, pra të jenë pjesë e operacioneve të ndryshme. Nga ky takim është e nevojshme të dalim me një kërkesë, tu bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve, që mos të ndezin zjarre, sidomos tani që jemi në prak të festës së 1 Majit, ditë kjo që po praktikohet me ndezje të zjarreve nga qytetarët, pra të përmbahen nga kjo dukuri, për shkak të ndotjes së ambientit por edhe rrezikshmërisë që paraqesin. Në këtë aspekt duhet të mobilizohen Policia, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mbrojtjes dhe Shpëtimit, duke përfshirë Shërbimin e Zjarrfikësve. Është e nevojshme të kontaktohen edhe përfaqësuesit e fshatrave në mënyrë që edhe ata të angazhohen. Ne do ti vazhdojmë kontaktet e rregullta të Drejtorisë me Policinë, me Agjencionin e Pyjeve, këtu na nevojitet edhe ndihma e Gjykatave dhe prokurorëve. Nga Drejtori i DBPZHR kërkohet të punojë shumë me pylltarë, sepse nëse këto zjarre janë të qëllimshme atëherë pylltarët duhet të jenë në dijeni lidhur me këtë sepse po ndodhin në periudha të caktuara, me qëllim të mbulimit të gjurmëve të prerjeve ilegale, ku si rrjedhojë krijohen dyshime. Duhet punuar të gjithë në këtë aspekt, më shumë kërkohet angazhim nga Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me pylltarët por edhe të gjithë ne të jemi në mbështetje dhe përkrahje. Nëse nuk ka dikush diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

6. Të ndryshme

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fjalën e ka z. Liman Zeqiri.

z. Liman Zeqiri, theksoi, është një fenomen në rritje, fjala është për fëmijët dhe persona tjerë që kërkojnë lëmoshë në komunën tonë. E them publikisht se këta persona po vijnë nga shteti i Shqipërisë dhe shpesh ka fëmijë që i zënë nata, në rrethana dhe kushte jashtëzakonisht të rënda, në të ftohët dhe temperatura mjaft të larta, nëpër trotuare, asfalt, për të cilët Policia mendoj se ka informacione. Ndoshta është vështirë për ta ndaluar, por kjo është një dukuri shqetësuese dhe ne si Këshill duhet të merremi me këtë. Ne e dimë që është gjendje e rëndë ekonomike. Është edhe një dukuri tjetër që shumë persona vijnë edhe në emër të shoqatave të ndryshme ku kërkojnë të holla nga qytetarët për shërim mjekësor. Është mirë të bëhet identifikimi i atyre personave apo shoqatave, të kemi respekt ndaj fëmijëve, sepse mund të bëhen keqpërdorime. Këta persona shkojnë nëpër fshatra dhe kërkojnë shtëpi për shtëpi, që nuk dihet se cilat janë ato shoqata. Në këtë aspekt si qytetarë duhet të koordinohemi sepse Policia nuk mund ti kontrollojë të gjitha.

z. Bekim Bislimi, sa i përket lëmoshës në rrugë, Policia ka ndërmarrë veprimet e duhura. Rastet janë proceduar në gjykatë dhe ka raste të depërtimeve të tyre. Nuk e mohoj që nuk kemi prap raste, mirëpo kjo çështje është në kuadër të planeve tona të rregullta operative dhe do të merremi në vazhdimësi. Kështu që e kemi parasyshë dhe do të punojmë në këtë drejtim për përmirësim të situatës, por presim një bashkëpunim edhe nga ana e qytetarëve, ngase është pamundur të mbulojmë terrenin me stafin që e kemi, adaj është e nevojshme të kemi informacione.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, lëmosha në rrugë është bërë një dukuri që i bie në sy të gjithëve. Kjo dukuri është vështirë të ndalet në tërësi, por duhet identifikuar personat dhe Policia të ketë informacionet e nevojshme. Unë kam edhe disa kërkesa prej qytetarëve, kryesisht për hapësirat publike, që janë duke bërë vërejtje për hapësira publike të cilat me fillimin e përmirësimit të kohës janë duke u bllokuar si prej lokaleve, veturave, me të cilat po pengohet lëvizja e lirë. Është mirë që këtë çështje ta diskutojmë në njërën nga mbledhjet e ardhshme, por deri atëherë të punojnë në këtë drejtim Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Inspeksioni në koordinim me Policinë dhe të shohim që kemi lëvizje pozitive.

Ju falënderoj, shihemi në takimin e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 10.55
Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani
Nr. 02-006-48226
Podujevë,
19 prill 2016

Kryetari i Komunës
Agim Veliu